VENDIM
Nr. 54, datë 30.12.2016

MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË U GRAMSH SHA

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U Gramsh sh.a.:
a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

Furnizim me ujë

Konsumator familjar:	32 lekë/m^3
Konsumator publik:	90 lekë/m^3
Ente private :	90 lekë/m^3

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar:	60 lekë/m^3
Konsumator publik:	180 lekë/m^3
Ente private :	150 lekë/m^3

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2017

- uji pa të ardhura (humbjet):	27%
- niveli i matjes klient familjarë:	55%
- niveli i matjes klient jofamiljarë:	100%
- kohëzgjatja e furnizimit:	24 orë/ditë
- eficienca e energjisë	
- uji i pijshëm	1.8 kwh/m^3
- eficienca e stafit:	9.7 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	100%
- norma e arkëtimit	93%
- cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore vjetore për U Gramsh sh.a. do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.
4. Vendimi i KKRR-së nr. 5, datë 19.1.2011, "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. U Gramsh", shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani